



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:048314

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762429

C.nr.246/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.Ll nga Vushtrria, të cilën e përfaqëson R.M avokat në Vushtrri, rruga ..., kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë dhe kompensimin e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit 633.49 euro, jashtë seance me datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.Ll nga Vushtrria.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 05.02.2021 (84 ditë pune), t'ia paguaj paditësit N.Ll, shumën prej 168.00 euro, ndërsa në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, t'ia paguaj shumën prej 465.49 euro, përkatësisht për ushqim dhe për shpërblim jubilar, shumën totale prej 633.49 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë (15.03.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi N.Ll nga Vushtrria, përmes përfaqësuesit të tij av. R.M, me datë 15.03.2021 ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që t'ia kompensoj ushqimin-shujtat për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 05.02.2021, (84 ditë pune), nga 2 euro në ditë, shumën prej 168.00

euro, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, t'ia kompensojë vlerën e një page bazë në shumën prej 465.49, apo shumën totale prej 633.49 euro për shujta dhe shpërblim jubilar, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës. Me parashtrësën e datës 30.10.2023, ka bërë precizimin e padisë, në atë mënyrë që ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, përveç kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe shpërblimin jubilar për 30 vite të përvojës së punës, t'ia kompensojë edhe diferencën në pagë për shkak të inflacionit në shumën prej 287.98, si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë për padi shumën prej 104.00 euro, për ndryshimin-precizimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 31.00, në shumën totale prej 239.00 euro.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse kanë arritur Marrëveshjen e Ndërmjetësimit me numër Nd.nr.843/23 të datës 17.11.2023, të cilën gjykata e ka aprovuar me Aktvendimin e datës 24.11.2023. Në marrëveshjen e arritur palët janë dakorduar që e paditura t'ia kompensojë paditësit në emër të inflacionit, shumën e përcaktuar më gjerësisht si në marrëveshje. Andaj, pjesë e kërkesëpadisë ka mbetur kompensimi i shujtave për ditët e pranisë në punë dhe i shpërblimit jubilar. Po ashtu, të autorizuarit e palëve janë pajtuar edhe për pagesën e shpenzimeve të procedurës, të specifikuara si në marrëveshjen e lartcekur.

Gjykata me aktvendimin C.nr.246/21 të datës 08.11.2022, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 10.11.2022, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 17.11.2022.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017, ndërsa paditësi e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 15.03.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020, dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Pra në kohën kur është deponuar padia në gjykatë, nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, andaj mungon baza ligjore. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta hedhë poshtë si të palejueshme.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, pasi që në mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga vendimi 10.Nr.74/21, i datës 03.02.2021, i lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilin paditësi i kishte përfunduar punësimi për shkak të pensionimit. Kontestues nuk ishte fakti se paditësi në periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 05.02.2021, ka 84 ditë pune dhe për këtë periudhë ka kërkuar kompensimin e ushqimit-shujtave prej 2 euro në ditë, pasi që ky fakt është vërtetuar me Vërtetimin Nr.2/20 të datës 10.03.2021, të lëshuar nga SHFMU “L...” në ..., Vushtrri. Po ashtu nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka më shumë se 30 vite të përvojës së punës tek e paditura, në bazë të së cilës ka kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, në vlerë të një page bazë prej 465.49 euro, e cila është vërtetuar me Listën e pagave të datës 29.01.2021, e gjithashtu nuk ishte kontestues fakti se e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, nuk i ka kompensuar paditësit ushqimin-shujtat për ditët e pranisë në punë dhe kompensimin e shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë.

Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditësit.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënjen e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245 paragrafit 1 përcakton se *“kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, dhe ajo e datës 22.01.2021, në nenin 35 par.7, përcakton se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, ndërsa par. 8 të këtij neni përcaktohet se *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë prej: 8.1. për 10 vjet*

të përvojës së punës në vlerë prej 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një pagë bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë prej 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.

Përveç dispozitave të lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës me datë 27.02.2023, ka nxjerr Mendimin Juridik me nr.40/2023, ku në pikën IV të këtij mendimi përcaktohet se “Kontrata Kolektive e Arsimit ne Kosove e lidhur me datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë), (ne tekstin e me tejme: Kontrata Kolektive e Arsimit ne Kosove e datës 18.04.2017) aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017 - 21.01.2021”, ndërsa në pikën VIII të këtij Mendimi përcaktohet se “Punëtorët ne bazë të Kontratës Kolektive te Arsimit ne Kosove të datës 18.04.2017, kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç,; përcaktohet me nenin 35 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20, 30, dhe 40, vjet te arrihet ne kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën IV, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20, 30, dhe 40 vjet duhet te jete te punëdhënësi i fundit”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe provave të çështjes, gjykata vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit N.LI është e themeltë dhe të njëjtit i takon e drejta që në emër të kompensimit të ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 05.02.2021 (84 ditë pune), t’i paguhet shuma prej 168.00 euro, duke përlllogaritur shumën prej dy euro për një ditë pune, fakt që është provuar me Vërtetimin Nr.2/20 të datës 10.03.2021, të lëshuar nga SHFMU “L...” në ..., Vushtrri.

Po ashtu paditësit i takon e drejta që në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës, në vlerë të një pagë bazë në shumën prej 465.49 euro, t’i paguhet shuma prej 465.49 euro. Faktin se paditësi ka më shumë se 30 vite përvojë pune tek e paditura dhe se vitin jubilar të punësimit për 30 vite e ka arritur në kohën kur Kontrata Kolektive e Arsimit ka qenë në fuqi, gjykata e konstatoi me vërtetimet si në vijim: vërtetimi nr.02/15 i datës 01.02.2021 i lëshuar nga SHF “M.V”, Vushtrri, me të cilin vërtetohet se paditësi ka punuar në periudhën 01.09.1979- 03.10.1982 (3 vite e 2 muaj), vërtetimi nr.11/21 i datës 04.02.2021, i lëshuar nga SHFMU “A.F” fshati, nga i cili vërtetohet se paditësi ka punuar në periudhën 01.09.1984- 08.10.1984 (1 muaj e 7 ditë), vërtetimi nr.76/21 i lëshuar nga SHFMU “H.P”, fshati, Komuna e

Obiliqit, nga i cili vërtetohet se paditësi ka punuar në periudhat 07.02.1983- 06.04.1983 dhe 08.10.1984- 31.08.1985 (gjithsejtë 1 vit e 24 ditë), vërtetimi nr.58 i datës 02.02.2021 i lëshuar nga SHF “N.F” Vushtrri, me të cilin vërtetohet se paditësi ka punuar në periudhën 01.09.1985- 31.08.1999 (13 vite e 10 muaj), vërtetimi nr.1080/2 i datës 02.02.2021 i lëshuar nga SHF “A.K”, Vushtrri, me të cilin vërtetohet se paditësi ka punuar në periudhën 01.09.2007- 31.08.2008 (1 vit), vërtetimi nr.165/2 i datës 01.02.2021 i lëshuar nga SHMU-..., Vushtrri, me të cilin vërtetohet se paditësi ka punuar në periudhën 01.09.2008- 17.02.2010 (1 vit e 5 muaj e 17 ditë), vërtetimi nr.05 i datës 05.02.2021 i lëshuar nga SHFMU “L..”, fshati, Vushtrri, me të cilin vërtetohet se paditësi ka punuar në periudhën 01.09.2011- 05.02.2021 (9 vite e 9 muaj e 12 ditë).

Nga analizimi i të gjitha vërtetimeve të lartcekura, gjykata gjeti se vitin jubilar të përvojës së punës prej 30 vitesh paditësi N.Ll e ka arritur me datë 02.10.2020, pra në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata e vlerësoi si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, ndërsa paditësi kërkesën e tij për kompensimin e ushqimit e ka parashtruar për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 05.02.2021, e po ashtu kërkesën për shpërbllim jubilar, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 15.03.2021.

Gjykata, përveç kërkesës kryesore paditësit ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (15.03.2021), e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për kamatën, me numër 265/2020, i datës 01.12.2020.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, edhe pse paditësi në padi i ka kërkuar, siç u theksua edhe më lartë, palët janë dakorduar për shpenzimet në procedurë të ndërmjetësimi, (për shumën në emër të përpilimit të padisë si dhe taksës gjyqësore për padi) andaj nuk ishin objekt i shqyrtimit të gjykatës.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:048314
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05762429

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.246/21, me datë 31.05.2024

Gjyqtari
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.